

Erigersi & Iva

## Talente në ndjekje të ëndrrës "TI"

Erigersi - 23 vjeç - aktualisht është kandidat i MSC në inxhinieri kompjuterike.

Që në moshë të vogël kur ishte 4 vjeç, ai u dha pas lojërave në kompjuter, duke kaluar me to orë të tëra. Gjatë kësaj kohe Erigersi zbuloi se bota e kompjuterit ofronte shumë më tepër se lojërat, dhe me kalimin e viteve interesat e tij u spostuan drejt fushës së programimit kompjuterik. Inxhinieria kompjuterike ishte zgjedhja e padiskutuar e Erigersit për studimet e larta. Megjithatë njohuritë e fituara në universitet nuk ishin të mjaftueshme për të shuar etjen e tij për të rejat më të fundit nga fusha e Teknologjisë së Informacionit (TI). "**Ka shumë punë për të rinjtë në sektorin TI, por jo të gjithë kanë aftësitë e duhura; platforma ALMOOC është një burim i çmuar për fitimin e aftësive të nevojshme, dhe një mundësi e madhe**

## Young talents follow IT dreams

Erigers, 23, is currently an MSC Computer Engineering candidate. He found his calling as a very small child: at the age of 4 he became obsessed with computer games and spent hours with them throughout his childhood. Eventually he discovered that there was more to a PC than just games, and his interests shifted to programming. Computer Engineering was Erigers's choice when reaching the age for college, but the knowledge acquired there was not sufficient to satisfy his thirst for the newest skills in ICT. **"There are plenty of jobs for young people on the IT sector, but not many have the right skills; ALMOOC is a precious source for acquiring such needed skills, and a great opportunity for those who want to be competitive**

**për ata që duan të jenë konkurrues në treg”** - thotë Erigersi. Pas ndjekjes së kurseve në ALMOOC, Erigersi tani punon me kohë të plotë për fondacionin Real Visualz, që ka iniciuar platformën ALMOOC.com në Shqipëri me mbështetjen e projektit RisiAlbania. Kjo platformë ofron falas kurse online në fushën e TI për shqiptarët që kanë nevojë të mësojnë më shumë apo të plotësojnë dijet e tyre me teknologjitë e fundit dhe teknikat e kodimit.

Një tjetër shembull i mirë i kësaj përvoje është Iva. Pasioni i Ivës për TI filloi

si një kureshtje fëminore në lidhje me elektronikën. Ajo ishte 5 vjeç kur çmontoi për herë të parë një radio. Iva -vajza e një elektriçisti të talentuar- u dha pas elektronikës duke parë të atin në punishte, rrethuar nga paisje difektoze që prisnin të riparoheshin. Sot, në moshën 24 vjeçare, Iva i është mirënjohëse babait që gjithmonë e motivonte kur e shihte teksa ajo mundohej të riparonte ndonjë pajisje të dëmtuar. Ai në njëfarë mënyre kultivoi tek Iva pasionin për elektronikën, dhe më vonë mbështeti vendimin e saj për të studiuar Inxhinieri Kompjuterike. Iva tashmë punon me kohë të plotë për një kompani Italiane me qendër në Durrës, ndërsa jep edhe mësim si pedagoge e jashtme në Universitet. Ashtu si Erigersi, edhe Iva ndjeu nevojën për të përmirësuar dijet në fushën e TI, dhe shtysën e gjeti tek ALMOOC.com. **“Unë jam ku jam sot, në sajë të nivelit të lartë profesional të kurseve në ALMOOC; ato shërbyen si një portë suksesi për mua, dhe do t’jua rekomandoja të gjithë atyre që duan të thellojnë njohuritë profesionale”** - thotë Iva.

**in the market”** – says Erigers. He is now working full time for the Real Visualz Foundation, which has launched ALMOOC.com, the online portal offering - with support from RisiAlbania - free IT courses to Albanians who are eager to learn about the latest technologies and coding techniques.

Another good example of the need for acquiring cutting-edge skills is Iva. Iva’s passion for electronics first announced itself when she dismantled a radio at the age of five. The daughter of a gifted electrician, Iva’s exposure to electronic components on her father’s workbench captured her imagination very early in her life. A curious girl, Iva hovered next to her father, who took pleasure in letting her reassemble electronic parts. Now 24, Iva is grateful to her father for cultivating her childhood fascination with electronics and supporting her decision to study Computer Engineering at university level. Iva works full time for an Italian software company located in Durres, Albania, while also holding a part time teaching position at her alma mater, Epoka University. Likewise, she felt the need to upgrade her levels of knowledge, and ALMOOC.com was the step forward. **“I am…where I am today, thanks to the high professional level of ALMOOC courses.Those courses were like a doorway to success for me, and I would definitely recommend ALMOOC to all who want to deepen their professional knowledge”** - says Iva.



Përmes platformës ALMOOC Iva dhe Erigersi përvehtësuan tendencat më të fundit në TI dhe hodhën hapa seriozë dhe të rëndësishëm përpara në karrierën e tyre si kodues, edhe pse janë shumë të rinj në moshë. Ndërkohë ALMOOC vazhdon të ofrojë online dhe falas për të rinjtë, një përzgjedhje interesante kursesh si Node JS, Ruby on Rails, apo Java për Android.

Pothuajse 800 të rinj shqiptarë kanë përfunduar tashmë kurse kodimi në ALMOOC.com; kurse që i kanë pajisur me shkathtësi dhe njohuri profesionale, të kërkuara nga tregu aktual i punës në sektorin TIK, jo vetëm në Shqipëri, por edhe jashtë vendit. Kjo platformë hap për të rinjtë jo vetëm dyer punësimi, por në mjaft raste ju mundëson atyre punën e ëndërruar, dhe karrierë të suksesshme.

It was ALMOOC.com that exposed Iva and Erigers to the latest trends of the IT world and unlocked unforeseen professional opportunities for them. Such opportunities came to them just at the right time, thanks to the online free IT courses they completed in this platform. Iva and Erigers have cast serious and important steps ahead in their careers as software developers, even though they are only in their early twenties. Meanwhile, ALMOOC.com continues to offer for young and talented people like Iva and Erigers a wide selection of free online courses such as Node Js, Ruby on Rails, Java for Android. Almost 800 young Albanians have already completed coding courses in ALMOOC.com; courses that equip them with relevant knowledge and professional skills, currently on demand by the ICT labour market, not only in Albania but also abroad. This platform can open not just several doors of employment, but in many cases can lead its followers find the chance of a life-time, for pursuing a dream job and a successful career.

